

Hapet Thirrja për Bursa për Studentët dhe Stafin e UT-së, në kuadër të Programit Erasmus + në Universitetin Alexandru Ioan Cuza të Iași, në Rumani

Në kuadër të programit Erasmus + është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për studentët dhe stafin e Universitetit të Tiranës në Universitetin Alexandru Ioan Cuza të Iași, në Rumani për semestrin e dytë të vitit akademik 2017-2018.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e studentëve për studime;
- Shkëmbimin e stafit akademik për mësimdhënie;
- Shkëmbimin e stafit administrativ për trajnim;

Nivelet e mobilitetit për studentët:

- **Bachelor:**
- **Master:** (studentët duhet të jenë të regjistruar në një program studimi Master në Universitetin e Tiranës)
- **Doktoraturë:** (studentët duhet të jenë të regjistruar në një program studimi të doktoraturës në Universitetin e Tiranës)

Kohëzgjatja e bursave:

- Bachelor, Master, Doktoraturë (5 muaj);
- Shkëmbimi i stafit administrativ për trajnim (5 ditë + 2 ditë udhëtim);
- Shkëmbimi i stafit akademik për mësimdhënie (5 ditë + 2 ditë udhëtim);

Fushat e studimit:

- Histori dhe arkeologji
- Filozofi dhe etikë
- Edukim
- Gjuhë të huaja

- Shkenca sociale dhe të sjelljes (shkenca politike, sociologji, dhe studime kulturore, psikologji)
- Gazetari dhe raportim
- Biznes dhe administrim (menaxhim dhe administrim, kontabilitet, financë, ekonomiks, marketing)
- Drejtësi
- Shkenca të Biologjisë (biologji, biokimi)
- Shkenca të fizikës (kimi, fizikë, shkencat e tokës)
- Matematikë dhe statistikë
- Teknologji informacioni dhe komunikimi

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin mujor (750 EUR në muaj për studentët/140 EUR në ditë për stafin)
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni link-ut:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Studentët që përfitojnë nga mobiliteti Erasmus + nuk do të paguajnë asnjë tarifë për shkollim në universitetin pritës. Studentët do të vazhdojnë të paguajnë shkollimin e tyre dhe/ose tarifën e regjistrimit në universitetin e tyre të origjinës.

Për më shumë informacion vizitoni <https://erasmusplus.uaic.ro/funding>

Dokumentat e nevojshme për aplikim:

Ju lutem vizitoni linkun <https://erasmusplus.uaic.ro/documents-to-be-uploaded> për t'u informuar rreth dokumentave që ju duhen për aplikim.

Vini re se për të gjitha certifikatat/diplomat/listat e notave duhen bërë upload versioni origjinal i skanuar si edhe përkthimi i autorizuar në gjuhën angleze (në rast se origjinali nuk është lëshuar në gjuhën angleze).

Një ndër dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët është dokumenti Learning Agreement.

**Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Before the mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihen në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në universitetin pritës lëndë të njëjta me ato që do të kryenit në semestrin e dytë të vitit akademik 2017/2018 në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t'ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillonit në fakultetin tuaj, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvillonit/frekuentoni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës.

Dokumenti “Learning Agreement” tek seksioni “Commitment” firmoset fillimisht nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe më pas në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.

Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën:

http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Learning_Agreement.pdf

Afati për aplikim: 15 Tetor 2017

Për të aplikuar ju lutemi vizitoni <https://erasmusplus.uaic.ro/wp-login.php?action=register>
Gjithë aplikimi është online.

Për më shumë informacion mbi bursat vizitoni <https://erasmusplus.uaic.ro/> ose mund të na kontaktoni në adresën iro@unitir.edu.al